Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

**”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për
Agregatorin Bujqësor”**

Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË
Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit³

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Në bazë të parashikimeve të neneve 28 dhe 37 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, të ndryshuar, Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të Konsulentit “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM Konsulentin “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo konsulenti tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

3. Nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, **me asnjë** nga anëtarët e stafit të autoritetit kontraktor, drejtpërdrejtë ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

³ Kjo deklaratë duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të stafit të konsulentit dhe do të jetë pjesë e dokumentave të ofertës së konsulentit.

”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për Agregatorin Bujqësor”

Shtojca 10

[*Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 11.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, seicili prej anëtarëve të bashkimit duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht⁴;
- b. Prokura e posaçme.

⁴ Në këtë marrëveshje nuk duhet të përcaktohet përqindja e shërbimeve të seicilit anëtar, por fushat/ekspertizat e marra përsipër për tu realizuar.

”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për Agregatorin Bujqësor”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4/1;
- b Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 8;
- c. Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit, sipas Shtojcës 9;
- ç. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 11/1;
- d. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 ”Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit” e dokumentave standarte te tenderit te cilat mbeshteten në nenin 46, të Ligjit Nr. 9643, datë 20/11/2006, “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe vërtetojnë se operatorët ekonomikë kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës. **Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 11.**

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Përsa i përket kapacitetit ekonomik e financiare, kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat minimale:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore/Vërtetim të gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik për xhiron mesatare vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare (2017, 2018, 2019) nga data e zhvillimit te tenderit lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit përkatësisht 5.000.000 (pesë milion) lekë pa tvsh.

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqese kopje të bilanceve të dy viteve të fundit 2018 dhe 2019, të paraqitur pranë autoritetit përkatës, të konfirmuara nga ky autoritet.

3.3 Kapaciteti teknik:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

3.3.1 Shërbime te ngjashme me objektin e prokurimit, me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 5.000.000 (pesë milion) lekë pa tvsh, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kur shërbimi i ngjashem është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetoje duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate.

”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për Agregatorin Bujqësor”

- Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore të shitjes të nënshkruar nga të dyja palët ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara të nënshkruara nga të dyja palët.

3.3.2 Operatori ekonomik duhet të zotërojë licencat profesionale të mëposhtme:

a) Liçensa për ushtrimin e veprimtarive të ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis;

b) Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategoritë:

Kategoria 1. PROJEKTIM URBANIST

c- Plane të detajuara vendore.

Kategoria 2. PROJEKTUES ARKITEKT

a- Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike.

Kategoria 3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

a- Projektim objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate

Kategoria 6. PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA

a- Projektim rruge lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore

3.3.3 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka në dispozicion burime njerëzore të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesave të kontratës.

a) Për përmbushjen e këtij kriteri, numri mesatar i të punësuarve duhet të jetë jo më pak se 5 (pesë), vërtuar me:

- Vërtetim lëshuar nga Administrata Tatimore, ku specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën gjashtë muajt e fundit (duke marrë si referencë datën e hapjes së ofertave).

- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi (formularët E-sig 025) për periudhën gjashtë muajt e fundit (duke marrë si referencë datën e hapjes së ofertave).

b) Konsulenti duhet të ketë në përbërje staf pune të kualifikuar për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit. Operatori ekonomik të ketë një Ekip të përbërë nga Ekspertë me eksperiencë të ngjashme në fushat respektive të ekspertizës, si më poshtë:

1) 1 (një) Ekspert kryesor/ Menaxher projekti

Diplomë universitare në nivel Master në fushat e ngjashme me shërbimet e kërkuara si, ekonomi apo agro-biznes. Të ketë të paktën 7 (shtatë) vjet eksperiencë pune, me njohuri dhe eksperiencë të mëparshme në nivel menaxherial në koordinim dhe implementim projektesh, si hartimi i studimeve të fizibilitetit apo planeve të biznesit. Të ketë njohuri të mira të organeve të qeverisjes vendore.

”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për Agregatorin Bujqësor”

2) 1 (një) Ekspert i Bujqësisë

Diplomë universitare në nivel Master në Agronomi, Hortikulturë ose në ndonjë fushë tjetër të ngjashme. Të ketë të paktën 7 (shtatë) vjet eksperiencë profesionale në hartimin e studimeve në fushat e bujqësisë dhe agropërpunimit.

3) 1 (një) Ekspert i Ekonomisë

Diplomë universitare në nivel Master në Ekonomi, Informatikë Ekonomike ose në ndonjë fushë tjetër të ngjashme. Të ketë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë profesionale, të tilla si, hartimi i planeve të biznesit/ studimeve të fizibilitetit, projeksionet e të ardhurave e shpenzimeve, etj të ngjashme me to.

4) 1 (një) Inxhinier Ndërtimi

Diplomë universitare në nivel Master në Inxhinieri Ndërtimi. Të ketë të paktën 7 (shtatë) vjet eksperiencë profesionale, në fusha të tilla si, përlllogaritje e kostove të ndërtimit për rrugë, infrastruktura ndërtimore, etj të ngjashme me to.

5) 1 (një) Arkitekt/ Projektues Urban

Diplomë universitare në fushën e Arkitekturës ose Planifikimit Urban. Eksperti duhet të ketë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë pune, të tilla si, hartimi i projekt-ideve arkitektonike, përcaktimin e rrugëve të brendshme, hartimin e planeve të detajuara vendore, etj. të ngjashme me to.

Për të vërtetuar kualifikimet, eksperiencën e punës dhe profilet e stafit/ ekipit të ekspertëve si më sipër, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin justifikues, si më poshtë:

1. CV

2. Librezë pune

3. Diplomë

4. Kontratë pune të vlefshme

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

**”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për
Agregatorin Bujqësor”**

Shtojca 11

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e ***anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik***, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP⁵.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

⁵ Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë

”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për Agregatorin Bujqësor”

- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

**”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për
Agregatorin Bujqësor”**

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE
LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

**”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për
Agregatorin Bujqësor”**

Shtojca 12

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për
Agregatorin Bujqësor”**

Shtojca 13

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për Agregatorin Bujqësor”

Shtojca 14

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: ”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për Agregatorin Bujqësor”

Hartimit i studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit do të realizohet brenda afatit **prej 3 muajsh (12 javë) duke filluar nga momenti i nënshkrimit të kontratës** me subjektin e kontraktuar. Kontraktori duhet të parashikojë dhe detajojë në mënyrë të saktë të gjitha fazat e punës së domosdoshme deri në momentin final, atë të miratimit të dorëzimit të produktit final. Procesi i punës për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit do t’i përmbahet grafikut të zbatimit të aktiviteteve si vijon:

	Aktivitetet	Javë											
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
	Analiza e kuadrit ligjor teknik												
Studim i Fizibilitetit	Analiza e fizibilitetit ekonomik												
	Vleresimi i ofertes se produkteve												
	Vleresimi i kerkeses per produktet e agregatorit												
	Ndryshimi i kerkeses ne vite												
	Analiza e fizibilitetit fizik												
	Pozicioni potencial i agregatorit te ri												
	Koncept-ide e struktures se agregatorit te ri												
	Skema operacionale e propozuar e menaxhimit												
	Analiza e Riskut												
	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis												
	Rekomandimet përfundimtare												
Plani i biznesit	Plani i Biznesit												

”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për Agregatorin Bujqësor”

Shtojca 15

TERMAT E REFERENCËS

SHËRBIME KONSULENCE

”SHËRBIME KONSULENCE PËR HARTIMIN E STUDIMIT TË FIZIBILITETIT DHE PLANIT TË BIZNESIT PËR AGREGATORIN BUJQËSOR”

1 Hyrje

Në territorin e Bashkisë Tiranë sipas censusit të vitit 2011 banojnë 514,069 banorë ku nga të cilët 418,495 banorë jetojnë në zonën urbane dhe 95,574 jetojnë në zonat rurale. Reforma administrativo-territoriale solli ndryshime në demografi duke qënë se territorit të Bashkisë Tiranë ju bashkangjiten 13 ish-komunat rurale, reflektuar kjo me një rritje prej 33% të popullsisë së saj. Sipas regjistrit kombëtar të gjendjes civile në Bashkinë Tiranë janë të regjistruar 834,603 banorë në vitin 2019.

Bazuar në sa më sipër, tendenca në rritje e popullsisë si dhe rritja e ndjeshme e industrisë së turizmit gjatë viteve të fundit ka çuar në rritje të kërkesës konsumatore për produktet bujqësore dhe blegtorale. Zinxhiri i tregëtimit të produkteve bujqësore e blegtorale në Tiranë është i organizuar në dy forma:

- në Tregun Agroushqimor me shumicë Kashar i cili operon në mënyrë private;
- në 8 tregje publike me pakicë të administruara nga Bashkia Tiranë.

Grumbullimi dhe tregëtimi me shumicë i produkteve bujqësore dhe blegtorale të prodhuara në zonat rurale të Tiranës sikurse dhe në zonat e tjera të Shqipërisë realizohet në Tregun Agroushqimor Kashar. Nisur nga ky fakt, është vënë re nevoja për ngritjen e një tregu të dytë shumice (agregator bujqësor) të këtyre produkteve i cili njëkohësisht do të mundësojë një lehtësim në daljen në treg të prodhuesve të zonave rurale të Tiranës si dhe jashtë saj.

2 Nevoja për Agregatorin Bujqësor të Tiranës

Bashkia Tiranë duke patur parasysh problematikat që lidhen me zinxhirin e tregëtimit të produkteve agro-ushqimore siç janë niveli i ulët i organizimit të prodhimit dhe shitjes së produkteve që vijnë nga zonat rurale të territorit të saj, shitjet direkte te konsumatori në një mënyrë jo të mirë-organizuar etj, ka ndërmarrë nismën e krijimit të një “Agregatori Bujqësor” me anë të të cilit synohet rregullimi i çështjeve të cituara sa më sipër si dhe të kënaqë në mënyrë të drejtëpërdrejtë kërkesat e grupeve të interesit të përfshira në këtë zinxhir.

Ndërtimi i agregatorit bujqësor do të jetë një ndër faktorët kryesorë që do të sjellë:

- lehtësimin e daljes së fermerit në treg;
- rritjen e prodhimit dhe të ardhurave të fermerit;
- mirë-organizimi i zinxhirit të tregëtimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- specializimi i fermerëve drejt një produkti të përcaktuar,

”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për Agregatorin Bujqësor”

Agregatori do të jetë një strukturë multifunkionale që lehtëson grumbullimin, shpërndarjen dhe tregtimin e produkteve bujqësore e blegtorale. Kjo strukturë do të përfshijë disa funksione:

- Grumbullimi kryesisht i prodhimeve bujqësore e blegtorale;
- Shpërndarja dhe tregtimi i produkteve bujqësore e blegtorale që vijnë kryesisht nga zonat rurale të Tiranës edhe më gjerë;
- Ofrimi i shërbimeve si sistem ftohës, larje, paketim të produkteve për prodhuesit, grumbulluesit dhe konsumatorët, që sjellin vlerë të shtuar në zinxhirin e vlerës ushqimore
- Krijimin e hapësirave lehtësuese për administrimin e agregatorit,
- Ofrimin e shërbimeve të bareve, restoranteve etj, të cilat do të përdorin produktet e tregtuara në këtë strukturë.

Në kuadër të ngritjes, strukturimit dhe funksionimit të Agregatorit Bujqësor, Bashkia Tiranë, me anë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 48, datë 03.05.2019 ka themeluar shoqërinë “Tirana Agrikulturë” sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e zotëruar në masën 100 (njëqind) % të kapitalit të shoqërisë nga Bashkia e Tiranës, dhe e cila ka si objekt veprimtarie, ofrimin e shërbimeve në fushën e bujqësisë, blegtorisë, agrikulturës, si dhe grumbullimin dhe shitjen e këtyre produkteve.

3 Pozicioni i pronës së identifikuar për ngritjen e Agregatorit Bujqësor

Bashkia Tiranë në kuadër të jetësimit të projektit të Agregatorit Bujqësor ka identifikuar si pasuri të përshtatshme nga këndvështrimi i pozicionimit gjeografik si dhe nga statusi juridik, pasurinë në pronësi të shtetit me nr. 915/5, ZK. 1605, Volum 11, Faqja 52, Indeks harte K-34-100-(28-A), lloji i pasurisë “Arë” me sipërfaqe totale 29450 m² e ndodhur në Farkë të Vogël . Si pozicionim gjeografik zona kadastrale ku bën pjesë pasuria e propozuar për ndërtimin e strukturës së Agregatorit Bujqësor shtrihet midis liqenit të Farkës dhe segmentit Jug-Lindor të unazës së madhe të Tiranës. Ky pozicionim i pasurisë krijon mundësinë e lidhjes së strukturës së Agregatorit me rrjetin rrugor qytetas dhe ndërqytetas nëpërmjet unazës së madhe.

4 Studimi i Fizibilitetit

Hartimi i studimit të fizibilitetit, ka si qëllim që të vendosë në dispozicion të Bashkisë Tiranë, një dokument i cili përmban një analizë të të gjitha aspekteve përbërës të projektit të propozuar, në mënyrë që Bashkia Tiranë, duke u bazuar mbi rezultatet e këtij studimi, të ketë mundësi për vendimmarrje të mëtejshme, në lidhje me projektin e Agregatorit Bujqësor.

Ky studimi fizibilitetit do të vlerësojë aspektet e përgjithshme, të cilat lidhen me vlerësimin e faktit nëse ka apo jo interes publik për realizimin e këtij projekti si dhe faktin nëse projekti harmonizohet me objektivat dhe planet e miratuara nga qeverisja qendrore apo vendore.

Studimi i fizibilitetit duhet të identifikojë karakteristikat kryesore të Agregatorit Bujqësor, të cilat duhet të shoqërohen me një analizë të thelluar të elementëve përbërës, të cilat përfshijnë aspektet teknike, ekonomike dhe financiare, si dhe ndikimin mjedisor e social të projektit.

Synimet kryesore të ndërtimit të Agregatorit do të jenë:

1. të ofrojë produkte autentike të zonës, me cilësi dhe çmim

”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për Agregatorin Bujqësor”

2. të stimulojë prodhimin vendas në zonën përreth Tiranës, dhe rrjedhimisht;
3. të gjenerojë vende pune

Studimi i Fizibilitetit do të ndahet (klasifikohet) në tre elemente kryesore përmbajtësore, dhe konkretisht:

1. Fizibiliteti ekonomik
2. Fizibiliteti teknik i ndërtimit të Agregatorit Bujqësor
3. Plani i Veprimeve dhe afatet potenciale për ndërtimin e Agregatorit.

4.1 Fizibiliteti ekonomik i Agregatorit Bujqësor të Tiranës

Bazuar në të dhënat ekzistuese zyrtare dhe të marra në terren, Konsulenti do të analizojë mundësinë e ngritjes së një strukture komplekse të Agregatorit të propozuar, në kontekstin e balancimit të kostove dhe të ardhurave potenciale që mund të gjenerojë një strukturë e tillë. Kjo mundësi financiare do të trajtohet duke krahasuar produktin bujqësor-blegtoral të zonës së Tiranës (Ofertën) me kërkesën reale dhe atë potenciale për këto produkte. Në këtë mënyrë do të analizohet nëse ka mospërputhje midis ofertës për produkte dhe kërkesës, si dhe mënyrat se si mund të stimulohet balanca.

4.1.1 Oferta e produkteve

Bazuar në metodologjinë e analizave ekonomike, do të trajtohet oferta e tregut, që në këtë rast përkthehet me kapacitetin prodhues bujqësor dhe blegtoral të zonës së Tiranës. Në këtë pjesë të dokumentit, Konsulenti do të bazohet në të dhënat e Regjistrit të Fermerëve të Bashkisë Tiranë, i cili përmban të dhënat më të përditësuara mbi aktivitetin bujqësor të fermerëve të Tiranës dhe prodhimin e tyre. Për reference mund të përdoret edhe metodologjia e përdorur në Planin Kombëtar të Territorit, dhe konkretisht në konceptin e Metabolizimit Urban dhe Fluksit të Ushqimit, duke analizuar të dhënat e agreguara për nivelet e prodhimit bujqësor dhe blegtoral në rajonin territorial përreth Tiranës gjatë viteve të fundit.

Qëllimi i kësaj analizë të dhënash do të konsistojë në krijimin e një panoramë të qartë të ofertës për prodhime bujqësore dhe blegtoriale të territoreve përreth Tiranës, të cilat me pas do të jenë produkt potencial për përpunim dhe tregëtim në strukturën e re të Agregatorit.

Të dhënat e agreguara do të paraqiten në mënyrë tabelare, duke respektuar metodologjinë e raportimit të INSTAT për sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë, dhe konkretisht

- Prodhimi i bimëve të arave
- Prodhimi i drufrutorëve
- Prodhimi i perimeve
- Numri I krerëve të bagëtive
- Prodhime blegtoriale
- Struktura e blegtorisë në njësi gjedhi

”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për Agregatorin Bujqësor”

- Sasia e qumështit të grumbulluar
- Nën-produktet e qumështit

Përveç të dhënave statistikore bazë të prodhimit, në këtë pjesë të analizës, Konsulenti do të analizojë dhe prezantojë dhe një panoramë të detajuar të sektorit privat të prodhimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale në zonën përreth Tiranës. Do të analizohen format e biznesit, llojet dhe sasi të produkteve të prodhuara dhe të tregëtuara, problemet dhe vështirësitë e hasura në punën e tyre si dhe alternativa për përmirësimin e punës.

Një nga rezultatet më të rëndësishme të kësaj fazë të studimit është krijimi i një ideje të saktë lidhur me kapacitetin e nevojshëm magazinues dhe përpunues të Agregatorit të ri, bazuar në ofertën e prodhimit bujqësor dhe blegtoral të zonës së Tiranës. Kjo do të ndihmojë në fazën e dytë të analizës së Fizibilitetit Teknik të Agregatorit, ku do të trajtohen elementet fizike dhe hapësinore të tij.

4.1.2 Kërkesa aktuale për produktet potenciale të Agregatorit

Në disiplinën e ekonomiksit, konsumatorët blejnë produkte për të plotësuar nevojat e caktuara të tyre. Por nevojat nuk është e njëjtë me kërkesën. Që një blerës të ketë kërkesë për një produkt, nuk është e mjaftueshme të ketë nevojë për të, ai duhet që njëkohësisht të jetë i gatshëm dhe ne gjendje të blejë këtë produkt. Në këtë pjesë të Studimit të Fizibilitetit, konsulenti do të analizojë me kujdes treguesit e kërkesës për produkte bujqësore dhe blegtorale në territorin e Tiranës, duke u referuar në:

- Nr i pikave të shitjes – të dhëna nga Bashkia, drejtoria e tatimeve, etj
- Sasi të shitura në tregjet e Tiranës;
- Sasi të shitura në Tregun AgroUshqimor të shumicës në Kashar;

Për sigurimin e të dhënave statistikore, konsulenti do të bazohet në të dhënat e INSTAT, Bashkisë Tiranë, intervista & pyetësore, etj. E rëndësishme në këtë pjesë të analizës do të jetë krijimi i një panorame të qartë lidhur me produktet me të kerkuara bujqësore dhe blegtorale në zonën e Tiranës, problematikat e ndryshme lidhur me ofertën për çdo produkt (nëse ka), etj.

4.1.3 Ndryshimi i kërkesës për produktet bujqësore dhe blegtorale në të ardhmen

Ndërkohë, analiza e kërkesës duhet të integrohet me përcaktimet e “Strategjisë së zhvillimit të qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022” si dhe në prognozatat e zhvillimit demografik të Tiranës, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor TIRANA 2030. Duke u bazuar në dinamikën aktuale demografike të Tiranës, me një rritje të vazhdueshme të popullsisë gjatë tre dekadave të fundit, në këtë pjesë të dokumentit të studimit të fizibilitetit do të analizohet ndryshimi potencial i kërkesës për produkte bujqësore dhe blegtorale në territorin e rajonit të Tiranës.

”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për Agregatorin Bujqësor”

Në këe logjikë, konsulenti do të përcaktojë ndryshimin potencial të kërkesës për produkte bujqësore dhe blegtorale gjatë viteve, në territorin e Tiranës, duke saktësuar kështu kapacitetet fizike në të ardhmen të Agregatorit.

Përfundimet e këtij kapitulli, konsulenti do ti paraqesë në formë tabelare, me të dhënat përkatëse për llojin e produkteve të konsumuara, sasi të konsumuara si dhe ndryshimi i sasive sipas periudhave kohore.

4.2 Fizibiliteti teknik i Agregatorit

Në këtë pjesë të dokumentit konsulenti do të analizojë komponentët fizike dhe urbanistike të strukturës së re potenciale të Agregatorit Bujqësor të Tiranës.

4.2.1 Pozicioni gjeografik i Agregatorit lidhur me skemën hapësinore të Tiranës

Konsulenti do të bazohet kryesisht në Planin e Përgjithshëm Vendor të Tiranës, duke shqyrtuar propozimet hapësinore në perspektive, kategoritë e përdorimit të tokës, mënyrat e ndërhyrjes dhe në mënyrë të veçantë elementët e propozuar të infrastrukturës rrugore. Në mënyrë të veçantë konsulenti do të analizojë hartën e vizionit të zhvillimit të Tiranës si dhe propozimet për zonat ekonomike. Përmes kësaj analize, konsulenti do të trajtojë disa alternativa potenciale të pozicionimit të Agregatorit të ri, përfshirë edhe alternativën e identifikuar nga Bashkia Tiranë, duke përcaktuar për çdo alternative faktorët pozitive dhe ato negative, të lidhur me:

- Aksesin e strukturës së re të Agregatorit ndaj qytetit të Tiranës dhe rrjetit kryesor rrugor urban. Aksesin do të analizohet si në terma të distancave ashtu edhe në terma kohore të transportit;
- Ekzistencën e hapësirave të lira për ndërtimin e Agregatorit (këtu do të vlerësohet gjithashtu tipi i pronësisë mbi tokën, duke favorizuar ndërtimin e strukturës së re në tokë me pronësi shtetërore);
- Ekzistencën e kufizimeve territoriale për zhvillimin (zona të ndjeshme mjedisore, monumente, zona ushtarake, etj)

Në këtë pjesë të dokumentit, konsulenti do të përpunojë materialet hartografike përkatëse, të kombinuara me skema grafike që ilustronë saktë alternativat e propozuara të pozicionimit të Agregatorit të ri bujqësor. Në përfundim, konsulenti do të sugjerojë alternativën më të mirë për sa i përket pozicionimit të Agregatorit të ri.

4.2.2 Karakteristikat fizike të strukturës së Agregatorit si dhe nevoja për hapësira magazinimi dhe përpunimi

Bazuar në përfundimet e analizës së ofertës dhe kërkesës për produkte bujqësore dhe blegtorale në qytetin e Tiranës, konsulenti do të analizojë nevojat për:

- Hapësira magazinimi për produktet bujqësore, të klasifikuara sipas llojit dhe stinëve
- Hapësira magazinimi për produkte blegtorale, hapësira frigoriferike
- Hapësira përpunimi të produkteve

”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për Agregatorin Bujqësor”

- Hapësira shërbimi dhe administrative
- Parkime
- Të dhëna të përgjithshme për nevojat për furnizimin me ujë, energji elektrike si dhe opsionet për ndërtimin e një strukture të qëndrueshme nga pikëpamja mjedisore.
- Rrjeti i kanalizimeve dhe mënyrat e trajtimit të ujërave të një strukture komplekse si Agregatori bujqësor

Në varësi të vlerave potenciale të hapësirave të nevojshme për Agregatorin e ri bujqësor konsulenti do të propozojë detajime teknike lidhur me teknologjinë e ndërtimit të strukturës së objektit, duke dhënë edhe specifikat teknike përkatëse për llojin e teknologjisë së përdorur. Konsulenti do të këtë parasysh minimizimin e kostove të ndërtimit të strukturës pa dëmtuar qëndrueshmërinë e saj dhe duke garantuar funksionimin normal të kompleksit. Për këtë gjë rekomandohet të shqyrtohen mundësitë e përdorimit të strukturave metalike dhe paneleve të lehtë, si një teknologji tashmë e provuar në ndërtimet me karakter industrial.

Bazuar edhe në pozicionin e sugjeruar për ndërtimin e Agregatorit, sipas pikës 5.1, konsulenti do të propozojë një projekt ide të strukturës së re, duke reflektuar këtu specifikimet teknike të materialeve të sugjeruara si dhe raportet e hapësirave të llogaritura. Projekt ideja do të referohet karakteristikave të zonës së propozuar për zhvillim dhe do të përmbajë planimetritë përkatëse, distancat, përdorimin e hapësirave si dhe volumetrinë 3d e cila do të japë një ide paraprake të volumit dhe arkitekturës së Agregatorit të ri.

Projekt ideja e paraqitur do të shoqërohet me preventivin paraprak të ndërtimit të strukturës së re të Agregatorit Bujqësor të Tiranës.

4.3 Skema operationale e funksionimit

Në këtë pjesë të dokumentit të Studimit të Fizibilitetit, konsulenti do të analizojë mënyrat & alternativat e funksionimit dhe të menaxhimit të strukturës së re të Agregatorit bujqësor të Tiranës. Në këtë pjesë, konsulenti do të ketë si pikë reference vendimin Nr. 48, datë 3.05.2019 “Për krijimin e Shoqërisë “Tirana Agrikulturë” sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë së Tiranës dhe miratimin e akteve të themelimit”. Bazuar në këtë vendim, Shoqëria “Tirana Agrikulturë” sh.p.k. ka të drejtë të shqyrtojë dhe të vlerësojë mundësinë e bashkëpunimit me shoqëri të tjera tregtare dhe të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me persona të tretë.

Bazuar sa më sipër, konsulenti do të konsultohet me përfaqësues të Bashkisë Tiranë dhe Shoqatës “Tirana Agrikulturë” për të evidentuar alternativën më të përshtatshme për menaxhimin operacional të Agregatorit të ri bujqësor. Kjo analizë do të bazohet në reduktimin e kostove të shfrytëzimit të Agregatorit si dhe rritjes së indikatorëve të performancës së shërbimit.

Në varësi të skemës së menaxhimit të identifikuar si më të përshtatshme, konsulenti do të bëjë llogaritje paraprake të kostove të operimit të kompleksit, duke trajtuar:

”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për Agregatorin Bujqësor”

- Kostot operacionale të strukturës së re, duke përfshirë qera (sipas alternativës) ndriçimin e brendshëm dhe të jashtëm të kompleksit, furnizimin me ujë, amortizimin, pastrimin dhe evakuimin e mbeturinave, ruajtjen dhe sigurinë fizike të objektit, kostot e mirëmbajtjes së magazinave, ambienteve frigoriferike, kosto transporti, karburant, etj. Gjithashtu në këto kosto duhet të përfshihet edhe kostoja e sigurimit fizik të të gjithë kompleksit të ri të Agregatorit Bujqësor;
- Kostot administrative – stafi operativ, stafi manaxherial, shpenzime kancelarie, telefoni, internet, etj;

4.4 Skema e marketimit

Edhe për këtë komponent, konsulenti do të analizojë dhe do të propozojë alternativat e marketimit të strukturës së re të Agregatorit të ri Bujqësor të Tiranës, duke identifikuar logon e re të strukturës dhe sloganin, si dhe elementët bazë të marketimit të kompleksit të ri në television dhe në mediat elektronike.

4.5 Analiza e Riskut

Në referencë të Standarteve Globale të Menaxhimit të Riskut Parimet dhe Guidat; ISO 31000:2009 dhe Guida 73:2009, Menaxhimi i Riskut –Terminologjia, përkufizimi i riskut është: *“Risku është efekti i pasigurisë në arritjen e objektivave dhe mund të shoqërohet me pasoja të cilat mund të jenë avantazhuese ose dizavantazhuese në varësi të situatës apo ngjarjes”*

Bazuar në këtë koncept, konsulenti do të kryejë procesin i identifikimit, vlerësimit, përgjigjes, monitorimit dhe raportimit të risqeve për ndërtimin e strukturës së Agregatorit të ri të Tiranës. Përmes kësaj analize të detajuar do të vlerësohen opsionet sipas të cilave Bashkia e Tiranës nuk do të ketë humbje financiare dhe kapitale nga iniciativa e zhvillimit të Agregatorit. Përveç kësaj, konsulenti do të punojë me plan veprimin për menaxhimin e riskut, i cili do të jetë instrumenti që do të zbatohet nga Shoqëria “Tiranë Agrikulturë” me qëllimin final për të alternuar risqet me të cilat ky subjekt mund të përballlet në vazhdim.

Plani i Menaxhimit të Risqeve për Agregatorin Bujqësor të Tiranës do të përcaktojë qartë llojin e risqeve të asociuara me llojin e aktivitetit, të cilat mund të identifikohen, analizohen dhe menaxhohen. Plani do të parashtrijë mënyrat se si aktivitete të menaxhimit të riskut do të performohen, rregjistrohen dhe monitorohen përgjatë ndërtimit dhe funksionimit të kompleksit të Agregatorit Bujqësor.

Nga pikëpamja metodologjike, përmbajtja e planit të menaxhimit të riskut mund të përfshijë:

- Caktimin e përgjegjësisë/ përgjegjësit për administrimin e një risku të caktuar;
- Politikën, përjasjen dhe parimet e menaxhimit të riskut të institucionit;
- Dokumentacionin e përdorur për Identifikimin e Riskut – rregjistri i riskut, mundësitë fillestare të përgjigjeve kundrejt riskut etj;

”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për Agregatorin Bujqësor”

- Rezultatet e analizave të riskut – shpërndarja e riskut, ekspozimi në kuadër të projektit, ngjarjes, situatës, risqet më të rëndësishme, ndryshimi i vlerave të rezultateve, objektivave si rrjedhojë e materializimit të riskut etj;
- Opsionet e reagimit ndaj risqeve- ndarja e riskut mes palëve të projektit, dispozitat, prokurimin dhe marrëveshjet kontraktuale në lidhje me riskun, planet e emergjencës, të sigurimit dhe marrëveshjet e tjera të transferimit të riskut në palë të tjera të përfshira apo jo në ngjarje;
- Monitorimin dhe kontrollin –krahësimi i situatës aktuale me atë të parashikuar dhe mbajtja e situatës nën kontroll dhe brenda pritshmërive

Nga pikëpamja e përmbajtjes, plani i menaxhimit të riskut të ndërtimit të Agregatorit të ri bujqësor të Tiranës do të trajtojë:

- Risqet e trullit
- Risqet e projektimit, ndërtimit dhe vënies në punësimin
- Risqet e funksionimit
- Risqet e kërkesës dhe risqe të tjera tregëtare
- Risqet ekonomike ose financiare
- Risqet e pronësisë së aseteve
- Risqet politike
- Risqet e ndryshimit të kuadrit ligjor
- Risqet e forcës madhore
- Analizen e ndjeshmërisë

4.6 Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Sipas metodologjisë standard të vlerësimeve mjedisore, Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) do të sigurojë një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi zhvillimin e propozuar duke përfshirë kushtet fizike atmosferike dhe të burimeve ujore dhe biologjike, burimet kulturore dhe gjëndjen social-ekonomike të zonës së propozuar për ndërtimin e Agregatorit Bujqësor të Tiranës.

Në procesin studimor të VNM do të përdoren informacioni dhe të dhënat ekzistuese dhe të përfituara rishtas mbi kushtet fizike dhe mjedisore të zonës, së bashku me standardet dhe normat e zbatueshme për të vlerësuar impaktet potenciale mjedisore dhe sociale të strukturës së propozuar.

5 Përmbajtja e dokumentit të Studimit të Fizibilitetit

Studimi i fizibilitetit për ngritjen dhe funksionimin e agregatorit bujqësor do të hartohet bazuar në përvojat dhe modelet më të suksesshme të këtyre iniciativave në rajon. Në terma teknike, dokumenti i Studimit të Fizibilitetit do të përmbajë:

”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për Agregatorin Bujqësor”

1. Përshkrimi i përgjithshëm i sfondit të zhvillimit strategjik të projektit;
2. Kuadri ligjor dhe teknik
3. Analiza e fizibilitetit ekonomik të Agregatorit
4. Analiza e fizibilitetit teknik dhe financiar të Agregatorit
5. Skema operationale e funksionimit
6. Skema e Marketimit
7. Analiza e riskut
8. Rekomandimet
9. Vleresimi i Ndikimit në Mjedis

6 Plani i biznesit

Hartimi i planit të biznesit, ka si qëllim që të vendosë në dispozicion të Bashkisë Tiranë, një dokument të detajuar që përmban strategjinë dhe parashikimin financiar të ngritjes dhe funksionimit të strukturës së agregatorit bujqësor. Ky dokument do të përcaktojë kapacitetet e përballimit të angazhimeve financiare për ngritjen dhe funksionimin e kompleksit të ri. Plani i biznesit për ngritjen dhe funksionimin e Agregatorit Bujqësor do të hartohet bazuar në përvojat dhe standartet më të mira të fushës. Plani i biznesit duhet të përmbajë dhe trajtojë çështjet si më poshtë:

1. Përmbledhje ekzekutive
 - 1.1 Qëllimi i planit të biznesit
 - 1.2 Analiza e tregut
 - 1.3 Kompania
 - 1.4 Aktiviteti i synuar dhe marketingu
 - 1.5 Kërkimi dhe zhvillimi i produktit ose shërbimit
2. Përshkrimi i aktivitetit
 - 2.1 Misioni
 - 2.2 Qëllimi
 - 2.3 Aktiviteti dhe synimi i biznesit
 - 2.4 Struktura legale e subjektit
 - 2.5 Struktura e aktivitetit dhe përshkrimi i diagramës
3. Analiza e tregut
 - 3.1 Përshkrimi i sektorit
 - 3.2 Tregu i synuar
 - 3.3 Konkurrentët dhe pozicioni i kompanisë me konkurrentët
 - 3.4 Mundësitë e reja të tregut (gjeografike, produktet e reja, shërbimi, klientela...)
 - 3.5 Barrierat për të hyrë në treg
4. Produktet dhe shërbimet
 - 4.1 Produkti i detajuar / përshkrimi i shërbimit (nga prespektiva e përdoruesit)
 - 4.2 Cikli i jetës së aktivitetit/shërbimit
 - 4.3 Aktivitetet e kërkim zhvillimit

”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për Agregatorin Bujqësor”

- 4.4 Patenta/marka....
- 5. Aktivitetet e marketingut
 - 5.1 Përcaktimi i strategjisë së marketingut
 - 5.2 Strategjia e shitjes
 - 5.3 Kontrolli i kreditit
- 6. Operacionet
 - 6.1 Procedurat e ofrimit të shërbimit
 - 6.2 Kapacitetet e ofrimit të shërbimit
 - 6.3 Avantazhet konkurruese operationale
- 7. Të dhëna financiare
 - 7.1 Lista e shpenzimeve kapitale kapitale
 - 7.2 Kostot operative
 - 7.3 Përlllogaritja e të ardhurave të pritshme
 - 7.4 Përpilim i Pasqyrës së pritshme të të Ardhurave dhe Shpenzimeve
 - 7.5 Analizë e Fluksit Monetar dhe përlllogaritja e treguesve financiarë si IRR dhe NPV
- 8. Plan financimi
 - 8.1. Plan i detajuar investimi
 - 8.2. Plan financimi...(investimi në tokë, projektim/studime, kosto ndërtimi, kosto infrastrukturë e përgjithshme, supervizion, kolaudim, taksa, shpenzime, etj, në varësi të projektit).

7 Marrëveshja e menaxhimit

Konsulenti do të jetë përgjegjës për menaxhimin e procesit të detyrave, burimeve njerëzore, logjistikës dhe shpenzimeve të lidhura me detyrat në aspektin kohor dhe përshtatshmërinë në konsultime të ngushta me Bashkinë e Tiranës. Procesi i përgjithshëm do të mbikëqyret nga **DZHER/DPPSZHE**. Raportimi dhe monitorimi i progresit të punës do të mbahet me operatorin në baza të rregullta.

8 Referenca ligjore

- Ligji nr. 139/2015 “Për vetqëverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.160, datë 21.12.2018, “Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022”;
- Vendim i Këshillit Bashkiak Nr. 83, datë 29.12.2016 dhe Vendimi i KKT Nr. 1, datë 14.04.2017 “Për miratimin e planit të përgjithshëm vendor, Bashkia Tiranë”, i ndryshuar.
- Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 48, datë 03.05.2019 “Për krijimin e shoqërisë “tirana agrikulturë” sh.p.k., si person juridik në pronësi të bashkisë së tiranës dhe miratimin e akteve të themelimit”

”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për Agregatorin Bujqësor”

- Urdhri i Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit për përlogaritjen e fondit limit dhe hartimin e termave të referencës për projektin “Shërbim Konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për agregatorin bujqësor”;

**”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për
Agregatorin Bujqësor”**

Shtojca 16

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁶

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u skualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

⁶ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

**”Shërbime konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për
Agregatorin Bujqësor”**

Shtojca 17

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data _____]

Për: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës*]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]

* * *

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Etj.

* * *

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
